



Universiteti “Ukshin Hoti” Prizren

Fakulteti i Filologjisë, Prizren

Programi: Gjuhë dhe Letërsi Angleze

PROGRAMI MËSIMOR						
Niveli i studimeve		Bachelor	Programi	Gjuhë dhe Letërsi Angleze	Viti akademik	2022/23
LËNDA		Gjuhë shqipe 1				
Viti	I parë		Obligative	Kodi	ECTS	5
Semestri	I parë					
Javët mësimore		15		Orët mësimore		
				Ligjërata	Ushtrime	
				2	2	
Metodologjia e mësimit dhe përshkrimit të lëndës		<p>Fonetika (nga greqishtja <i>phone</i> – tingull) është ajo degë e gjuhësisë që studion mjetet tingullore të gjuhës, shfaqet dhe funksionet e tyre.</p> <p>Leksikologjia është shkencë gjuhësore, që studion fjalët si njësi leksikore dhe leksikun, pra tërësinë e fjalëve si nga ndërtimi ashtu edhe nga kuptimi i tyre.</p> <p>Morfologjia (nga greqishtja <i>morfo</i> = formë dhe <i>logos</i> = fjalë, dije) është pjesë e gramatikës, e cila merret me studimin e trajtëformimit dhe të formave të ndryshme që kanë format (e ndryshme) të fjalëve të lakueshme (emrat, mbiemrat, përemrat dhe numërorët) ose të zgjedhueshme (foljet). Morfologjia merret me klasifikimin dhe studimin e fjalëve në kategori leksiko-gramatikore (studim qendror ka fjalëformimin në koncept morfologjik dhe morfologjiko- sintaksor). Objekti i lëndës është studimi i fjalës në përgjithësi.</p>				
Konsultime		E mërkurë dhe e enjte prej orës 12:00 – 14:00				
Mësimdhënësi		Prof. asoc. dr. Shkëlqim Millaku		e-mail	shkelqim.millaku@uni-prizren.com	
		Mr.sc.Rinor Matoshi		Tel.	044-886466	
Qëllimi studimor i lëndës				Përfitimet e studentit		
<p>Kursi do t’iu ndihmojë studentëve për të shkruar drejt dhe saktë, njohur, shprehur dhe menduar në nivel akademik për problemet gjuhësore të fonetikës, leksikologjisë dhe për pjesët e ndryshueshme dhe të pandryshueshme të ligjëratave (morfologjisë). Nga ky kurs, studentët parapërgatiten për të hyrë në karrierën e tyre, e cila do të jetë e kompletuar, profesionalisht pasi që studenti ka arritur objektivat e qëllimit të lëndës së fonetiko-leksikologjisë dhe të morfologjisë. Kursi do të përfshijë mësimet teorike dhe praktike. Ai do</p>				<p>Studentët do të dinë se aftësia për të shkruar mirë është shkathtësi esenciale për komunikim, studim dhe nxenie. Andaj, të shkruarit dhe përdorimit të drejtë të emrit, mbiemrit, foljes (...), promovon aftësinë e të menduarit dhe të studiuarit. Gjithashtu, do të mësojnë se si do të mund t’u ndihmojnë fëmijëve, studentëve që t’i zhvillojnë shkathtësitë e të mësuarit, shkruarit dhe komunikuarit në klasat dhe jetën e tyre.</p> <p>Studentët do të jenë në gjendje të demonstrojnë shkathtësi në procesin e të shkruarit; gjenerimin e ideve, përgatitjen e drafteve, rishikimin, editimin dhe prezantimin e tyre. Ata do të jenë në gjendje të</p>		

<p>të përfshijë shkrimin dhe leximin e punimeve, prezantimeve me shkrim gjatë orëve mësimore dhe detyrave hulumtuese në shtëpi. Qëllimi i lëndës është që ta informon studentin për mundësin e studimit të fjalës, e cila lëndë “fjala” ofron studim bërthamë për morfologjinë dhe për profesionin e tyre. <i>Njohja e thellë</i> e paradigmave të lakimit të emrave sipas tipit të lakimit, në rase të ndryshme të trajtës se shquar dhe të pashquar, në njëjës dhe shumës do të jetë për studentin edhe kjo një sfidë e radhës për ta kompletuar dhe studiuar morfologjinë. Po kështu, edhe paradigma e zgjedhimit të foljeve sipas tipit të zgjedhimit, të mënyrës dhe kohëve të ndryshme do të jetë çështje thelbësore e studimit. Qëllimi thelbësor është njohja dhe përdorimi i lirshëm i pjesëve të ligjëratave dhe studimin e tyre.</p>	<p>shkruajnë për qëllime të ndryshme (tregime, shpjegime, argumentime në pikëpamje të caktuara, analiza dhe sinteza të ideve). Studentët do të jenë në gjendje të përshtatin tekstin e tyre publikut të ndryshëm (profesorëve, prindërve dhe fëmijëve që i mësojnë, moshatarëve dhe publikut më të gjerë). Ata do të jenë në gjendje që:</p> <ol style="list-style-type: none"> t’i shkruajnë dhe shqiptojnë drejt sipas normave të kodifikuara fjalët, fjalitë dhe trajtat e ndryshme të tyre; të aftësohen dhe t’i vërejnë (korrigjojnë) gabimet drejtshkrimore në tekste; t’i përdorin drejt emrat në shquarsi dhe pashquarsi, njëjës dhe shumës; mbiemrin; foljen, ndajfoljen, numërori; përemri; parafjalën; lidhëzën; pjesëzën dhe pasthirmën. Interpretojnë dhe argumentojnë studimin e morfologjisë, si të pavarur.
---	---

<p>Metodologjia për realizimin e temave mësimore:</p>		
<p>Ligjërata të kombinuara si: shpjegim – sqarim, ushtrime, analiza tekstore e shkencore, diskutime, punë në grupe, demonstrime dhe interpretime, shtruarje e shqyrtim idesh, hartime krijuese, vetë hulumtuese etj. Këto do të jenë pjesë kryesore për punën e vlerësimit dhe mënyrën apo metodologjinë e të ligjëruarit.</p>		
<p>Kushtet për realizimin e temës mësimore:</p>		
<p>Varësisht nga tema mund të organizohen dhe realizohen përmes komunikimit interaktiv, ligjërata në modelin klasik, përmes (kompjuterit dhe projektorit) etj. Këto edhe mënyra të tjera të ligjëruarit kërkojnë kushte të mira, si ndriçim në klasë, numri i studentëve të jetë sipas standardit të parapara, të kemi internet dhe elemente të tjera elektronike, të cilat mundësojnë realizimin e koncepteve teorike dhe praktike.</p>		
<p>Mënyra e vlerësimit të studentit (në%)</p>		
<p>Vlerësimi do të bëhet duke u mbështetur në, vlerësimet me shkrim (dy teste gjatë vitit akademik), seminare, detyra të shtëpisë, angazhime në klasë dhe në testin</p>	<p>Vlerësimi në %</p>	<p>Nota përfundimtare</p> <p>Vlerat e pikëve:</p> <p>1. 50-60 = 6</p>

<p>përfundimtar që do të jetë me shkrim dhe komunikim.</p> <p>Pikët e vlerësimit:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Testi i parë: 1-30 pikë 2. Testi i dytë: 1-30 pikë 3. Vijimi i rregullt dhe aktiviteti në klasë: 1-20 pikë 4. Vlerësimi i fundit testi përfundimtar (pyetje-përgjigje gojarisht): 1-20 pikë 5. Totali: 100 pikë 		<ol style="list-style-type: none"> 2. 61-70 = 7 3. 71-80 = 8 4. 81-90 = 9 5. 91-100 = 10 <p>Studentët me rezultat të përgjithshëm nën 50 pikë nuk mbërrijnë notën e kalueshmërisë.</p>

Obligimet e studentit: Të jenë pjesëmarrës aktiv në gjitha aktivitetet e parapara në plan-program.

Ligjërata

Të jenë pjesëmarrës aktiv, të kompletuar dhe të përgatitur me pajisje mësimore dhe studimore.

Ushtrime

Fletore pune për t'i ushtruar temat të cilat janë ligjëruar, për t'i prezantuar dhe demonstruara se cili njohurit e tyre për temat e mësuara dhe studiuara etj.

Me fletore pune dëshmon në fund të pjesës se provimit që organizohet me komunikim.

Ngarkesa e studentit për lëndën

Aktiviteti	Orë	Ditë	Javë	Gjithsej
Ligjërata	2	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	1	15	30
Punë praktike				
Kontakte me mësimdhënësin/konsultime	1	1	15	10
Ushtrime në terren				
Seminare, teste, kolokfiume etj.	5	2	2	5
Detyrat e shtëpisë	5	1	5	5
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	5	15	30

Përgatitja përfundimtare për provim	9	1	3	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, në provim final)	5	3	3	5
Projekte, prezantimet etj.		1	1	
Totali				125 125:25=5 ETCS 5

Java	Ligjërata	Orët	Ushtrime	Orët
1.	Tema Historia dhe raportet e gjuhës shqipe me familjen e gjuhëve indoevropiane, Ligjërimi, gjuha dhe të folurit, Karakteritë të gjuhës shqipe, Funksionet e ligjërimit, Gjuha dhe përbërësit e saj, Tingujt e gjuhës shqipe, Nyjëtimi, Zanoret, Bashkëtingëlloret.	2	Analiza dhe ushtrime nga një fragment i tekstit parauniversitar për temat e ligjëruara.	2
2.	Struktura e fjalës Tipat e fjalëve nga pikëpamja e përbërjes strukturore Fjala dhe morfema, Llojet e morfemave, Temat e fjalës, Fjalët e thjeshta dhe të përbëra, Prejardhja e fjalës. Nyjëzimi, Kompozimi, Përngjitja, Konversioni, Mënyrat e përziera.	2	Analiza dhe ushtrime nga një fragment i tekstit parauniversitar për temat e ligjëruara.	2
	Temat e seminarit (obliguese)			

3.	a) Fusha kuptimore e fjalës, b) Kuptimi i figurshëm i fjalëve në shqipe, c) Homonimet, ç) Sinonimet, d) Antonimet, dh) Shprehjet frazeologjike.	2	Analiza dhe ushtrime nga një fragment i tekstit parauniversitar për temat e ligjëruara.	2
4.	Emri, Njohurit e përgjithshme të emrit, Emrat e përgjithshëm, të përveçëm (konkretë, abstraktë ...), Kategoria e gjinisë së emrit, numrit.	2	Analiza dhe ushtrime nga një fragment i tekstit parauniversitar për temat e ligjëruara.	2
5.	Kategoria e rasës së emrit, Tipi i lakimit të emrit, Kategoria e shquarsisë dhe pashquarsisë.	2	Analiza dhe ushtrime nga një fragment i tekstit parauniversitar për temat e ligjëruara.	2
6.	Mënyra e formimit të emrave, Formimi parashtesor, Formimi prapashtesor, Formimi parashtesor-prapashtesor.	2	Analiza dhe ushtrime nga një fragment i tekstit parauniversitar për temat e ligjëruara.	2
7.	Emrat e përbërë, Emrat e përngjitur, Test vlerësuese.	2	Analiza dhe ushtrime nga një fragment i tekstit parauniversitar për temat e ligjëruara.	2
8.	Mbiemri, Klasifikimi i mbiemrave, Mbiemrat cilësorë,	2	Analiza dhe ushtrime nga një fragment i tekstit parauniversitar për temat e ligjëruara.	2

	Mbiemrat marrëdhëniorë, Mbiemrat të nyjshëm dhe i panyjshëm, Mbiemrat me nyjëzim, Mbiemrat e përbërë.			
9.	Numërori. Dorëzimi dhe prezantimi i seminareve <i>Seminaret duhen të dorëzohen vetëm në javën e nëntë të ligjëratave”. Pa mbaruar dhe pranuar seminarin nuk lejohet hyrja në provimin përfundimtar.</i>	2	Analiza dhe ushtrime nga një fragment i tekstit parauniversitar për temat paraprakisht të ligjëruara.	2
10.	Përemri (Llojet e përemrave). Test	2	Analiza dhe ushtrime nga një fragment i tekstit parauniversitar për temat e ligjëruara.	2
11.	Folja, Foljet ndihmëse dhe gjysmëndihmëse, Foljet kalimtare dhe jokalimtare, Kategoria gramatikore e foljes.	2	Analiza dhe ushtrime nga një fragment i tekstit parauniversitar për temat e ligjëruara.	2
12.	Zgjedhimi vepror, Format e shtjelluara.	2	Analiza dhe ushtrime nga një fragment i tekstit parauniversitar për temat e ligjëruara.	2
13.	Formimi i foljeve, Foljet e parme dhe jo të parme, Foljet e prejardhura.	2	Analiza dhe ushtrime nga një fragment i tekstit parauniversitar për temat e ligjëruara.	2

	Test			
14.	Ndajfolja, Parafjala.	2	Analiza dhe ushtrime nga një fragment i tekstit parauniversitar për temat e ligjëruara.	2
15.	Lidhëza, Pjesëza, Pasthirrma, Përmbledhja e lëndës se morfologjisë.	2	Analiza dhe ushtrime nga një fragment i tekstit parauniversitar për temat e ligjëruara.	2

LITERATURA

I

Grup autorësh, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002.

Shkelqim Millaku, *Tekst ushtrimesh për lakimin e emrave dhe zgjedhimin e foljeve*, Prishtinë, 2017

II

Shaban Demiraj, *Sistemi i lakimit në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1975.

Eqrem Çabej, *Studime gjuhësore III*, Prishtinë, 1976.

Shkelqim Millaku, *Studime gjuhësore I*, Prishtinë, 2011.

Xhuvani & E. Çabej, *Parashtesat e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1956.

Anastas Dodi, *Fonetika dhe Fonologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2004.

Jani Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2011.

Shkelqim Millaku, *Kërkime gjuhësore*, Prizren, 2015.

VËREJTJE